



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 28 Qershor 2022

Nr: 175

**VENDIM**

**PËR**

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË INSTITUTIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E SISTEMIT TË ZGJEDHJEVE, PËR SHTYRJEN E AFATIT PËR MBLEDHJEN E NËNSHKRIMEVE MBËSHTETËSE PËR PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 10019, DATË 29.12.2008 “KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 19, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ligjit nr. 54/2019 “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë” dhe neneve 33, 42, 47, 53, 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur dhe diskutimet e përfaqësuesve të komitetit të nismës ligjvënëse, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

**V Ë R E N:**

Instituti Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve, me përfaqësues të nismës ligjvënëse të zgjedhësve z. Kristaq Kume, Qendra për Progres Rinor – Kukës me përfaqësues z. Lavdërim Shehu, Shoqata “Hapa të Lehtë” – Shkodër me përfaqësues zj. Denada Shpuza, Shoqata “Komuniteti Malazes në Shqipëri” – Elbasan me përfaqësues z. Marinko Cullafiq, Qendra “Tamara” – Tiranë me përfaqësues zj. Liridona Hoxha, Qendra për Zhvillim të Shoqërisë Civile – Durrës me përfaqësues zj. Mirjam Reçi, Forumi “Mendimi i Lirë” me përfaqësues z. Mentor Kikia dhe Shoqata “Zëri Qytetar” – Lushnjë me përfaqësues zj. Denada Korreshi, kanë paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kërkesën për pajisje me fletë tip për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.



Data: 28 Qershor 2022  
Nr. 175

“Për shqyrtimin e kërkesës së Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit të Zgjedhjeve, për shtyrjen e afatit për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 142, datë 08.04.2022 vendosi miratimin e fletës tip për mbledhjen e nënshkrimeve për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë, për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Vendimi i sipërcituar ka përcaktuar afatin 3 (tre) mujor nga hyrja në fuqi e këtij vendimi për mbledhjen e nënshkrimeve. Afati përfundimtar për depozitimin e fletëve për mbledhjen e nënshkrimeve për t’u depozituar në KQZ nga përfaqësia/ komiteti përfaqësues i nismës, është data 08.07.2022.

Pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve është depozituar kërkesa me nr. 21 prot., datë 17.06.2022, administruar nga KQZ me nr. 2738 prot., datë 20.06.2022, për shtyrjen e afatit të përcaktuar në vendimin nr. 142, datë 08.04.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme nga komiteti përfaqësues i nismës ligjvënëse.

Në mbështetje të neneve 33, 42, 47, 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve thirri si palë në këtë shqyrtim administrativ përfaqësuesit e nismës ligjvënëse për të dhënë mendime dhe shpjegime për kërkesën në seancën dëgjimore.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, më datë 28.06.2022, ora 10:30 zhvilloi seancën dëgjimore ku ishte i pranishëm përfaqësuesi i komitetit përfaqësues të nismës ligjvënëse z. Kristaq Kume i cili parashtrroi se: *“Nga një grupim organizatash të shoqërisë civile, me mbështetjen e projektit Lëviz Albania dhe Zyrës Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim është ndërmarrë nisma ligjvënëse për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, ndryshime të cilat do të prekin vetëm dispozitat e Kodit Zgjedhor që lidhen me zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Aktualisht, së bashku me partnerët kemi arritur të mbledhim 72% të firmave mbështetëse, një progres i tillë pune i cili premtion plotësimin sipas vendimmarrjes së parë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Por ajo që duhet theksuar dhe ka qenë motivi më i fortë pse kërkojmë që ju të rishikoni edhe njëherë afatin e përfundimit të këtij procesi, ka të bëjë me atë situatë që ne u ndeshëm gjatë mbledhjes së firmave mbështetëse. Reagimi i qytetarëve ishte larg pritshmërive tona dhe një nga arsytet sipas analizës sonë lidhet me faktin që qytetarët nuk janë të mirëinformuar për të drejtat e tyre, çdo të thotë të ushtrosh të drejtën kushtetuese për të qenë ligjvënës, se çfarë fuqie ka një ligjvënës qytetar me një ligjpropozues në Kuvendin e Shqipërisë. Të përballur me këtë situatë, ne kemi komunikuar edhe me donatorët tanë dhe u kemi kërkuar që këtë punë të nisur ta shtyjme edhe disa muaj të tjerë*



*duke i kushtuar vëmendje të shtuar kontakteve me qytetarët, informimin, nxitjen dhe ndërgjegjësimin e tyre për vlerat që ka pjesëmarrja në ligjbërje. Ndërkohë jemi duke punuar në zhvillimin e kësaj qasje të re. Kërkesa jonë nuk ka të bëjë thjesht dhe vetëm me mundësitë kohore për të realizuar procesin formal të grumbullimit të 20 000 firmave por përdorimin sa më efektiv në funksion të zhvillimit të kulturës së pjesëmarrjes për të qenë pjesë e proceseve demokratike”.*

Ligji nr. 54/2019 “Për Nismën Ligjvënëse të Zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë” nuk parashikon afat konkret për mbledhjen e nënshkrimeve në vende publike apo private, si edhe të nënshkrimeve elektronike. Në këto kushte, afati 3 (tre) mujor i parashikuar në vendimin nr. 142, datë 08.04.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, është përcaktuar sipas propozimit të përfaqësisë/komitetit përfaqësues, referuar nenit 13, pika 1, të ligjit të sipërcituar. Referuar nenit 53, pika 3, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet shprehimisht se: “...afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit”.

Referuar pikës 3, të nenit 53, të ligjit nr. 44/ 2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe duke marrë në konsideratë se kërkesa është dorëzuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve përpara mbarimit të afatit 3 (tre) mujor si dhe argumentat e parashtruara nga ana e kërkuarit në seancë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vlerësoi si të ligjshme kërkesën për zgjatjen e afatit për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 53, pika 3, të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë,

## V E N D O S I:

1. Të zgjasë afatin për mbledhjen e nënshkrimeve mbështetëse për propozimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, deri në datën 30 Tetor 2022.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

